

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Paralajmëron kryetarja e AMA-s: Mos promovoni dhunën. Masa ndëshkimore për shkelësit e ligjit

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ka reaguar për mënyrën sesi mediat audiovizive vijuan me raportimet nga terreni, pas ngjarjes së rëndë...



Krasniqi në takimin e 62-të të EPRA-s: Kemi realizuar Transparencën e Strukturës së Pronësisë së Medias dhe studimin mbi investimet e OSHMA-ve



Asambleja e 24-të Plenare e MNRA-së, mbrojtja e fëmijëve në mjedisin online objektiv themelor i AMA-s

Në mbledhjen e 24-të Plenare të Rrjetit Mesdhetar të Enteve Rregullatore të Mediave, MNRA, Komisioni i Pavarur i Mediave të Kosovës mori Presidencën e radhës...

AMA mbështet studimin “Gazetaria në epokën e ndryshimeve teknologjike”, kryer nga Departamenti i Gazetarisë

Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi ishte e ftuar në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, ku u prezantua studimi, “Profesioni i gazetarit...”



Kryetarja e AMA-s raporton në Kuvendin e Shqipërisë për punët e kryera gjatë vitit 2024

Përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, prezantoi disa nga prioritetet e punës së institucionit...

Krasniqi në takimin e 62-të të EPRA-s: Kemi realizuar Transparencën e Strukturës së Pronësisë së Medias dhe studimin mbi investimet e OSHMA-ve

Kryetarja e AMA-s, Armela Krasniqi ka marrë pjesë në takimin e 62-të të Platformës Europiane të Enteve Rregullatore, (EPRA). Krasniqi ka shpjeguar për anëtarët e EPRA-s, se AMA ka krijuar dhe publikuar një databazë gjithëpërfshirëse mbi Transparencën e Strukturës Pronësore, e cila është e aksesueshme përmes faqes zyrtare të institucionit. Një prezantim të plotë të databazës kryetarja bëri dhe në Forumin e 11-të i Zhvillimit të Medias (MDF), organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. **Lexo më shumë**



Paralajmëron kryetarja e AMA-s: Mos promovoni dhunën. Masa ndëshkimore për shkelësit e ligjit

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ka reaguar për mënyrën sesi mediat audiovizive vijuan me raportimet nga terreni, pas ngjarjes së rëndë, që ndodhi në mjediset e Gjykatës së Apelit në Tiranë, ku u qëllua për vdekje gjykatësi Astrit Kalaja. Ajo bëri me dije se ditën e ngjarjes AMA dha 13 masa "Tërheqje vëmendje" për 13 televizione ndërsa ka bërë thirrje që t'i jepet fund transmetimit të pamjeve që nxisin dhunë.

Lexo më shumë



Asamblenë e 24-të Plenare të MNRA-së, Znj. Krasniqi: Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, objektiv madhor

Në mbledhjen e 24-të Plenare të Rrjetit Mesdhetar të Enteve Rregullatore të Mediave, MNRA, Komisioni i Pavarur i Mediave të Kosovës mori Presidencën e radhës. Në prezantimin e saj Znj. Krasniqi ka theksuar rëndësinë jetike të mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, si një dimension thelbësor i misionit rregullator.

Lexo më shumë

AMA mbështet studimin "Gazetaria në epokën e ndryshimeve teknologjike", kryer nga Departamenti i Gazetarisë



Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi ishte e ftuar në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, ku u prezantua studimi, "Profesioni i gazetarit dhe gazetaria në epokën e ndryshimeve teknologjike dhe mediave të reja". Ky projekt u mbështet nga AMA dhe solli gjetje interesante sa i përket formave dhe përshtatjes së gazetarëve në epokën digjitale.

Lexo më shumë



Kryetarja e AMA-s raporton në Kuvendin e Shqipërisë për punët e kryera gjatë vitit 2024

Përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, prezantoi disa nga prioritetet e punës së institucionit gjatë vitit 2024. Ajo renditi ndër të parat detyra të realizuara, përbushjen e cilësisë dhe efektivitetin e rolit mbikëqyrës e rregullator të AMA-s, falë funksionimit të Autoritetit si një ent plotësisht i pavarur në ushtrimin e detyrave.

Lexo më shumë